



Planimi / Detecuar Punë/Procedura Receve/Deputati	04.08	202	3	viti i vitit yjet
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	KOMSHICK	56121	2023	115



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.878/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë me Kaltrina Avdullahi-Prenaj Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.878/2023 të datës 23.06.2023 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë: Fshati [redacted], Komuna e Gjilanit, kundër Vendimit me numër Nr.02-60292 të datës 21.06.2023, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 04.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.878/2023 e datës 23.06.2023 e parashtrua nga ankuesi [redacted].
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër Nr.02-60292 i datës 21.06.2023 i Komisionit të Pranimit në Komunën e Gjilanit.

A r s y e t i m

Komuna e Gjilanit duke u bazuar u bazuar në dispozitat e nenit 34 paragrafi 2 dhe 3 dhe nenin 7 dhe 9 i Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, fillimisht më datë 15.03.2023 ka njoftuar për konkursin me numër të referencës Nr. RN00011142, ndërsa më datë 05.04.2023 ka shpallur konkursin e jashtëm për emrin e grupit Specialistë Ligjor, lidhur me pozitën e punës „Zyrtar Ligjor 2” një (1) pozitë në kuadër të Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë/Sektorit i Kadastrit .

Në bazë të listës së aplikacioneve në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi. Kryetari i Komunës së Gjilanit më datë 12.04.2023 ka nxjerrë Vendim me numër Nr.02-476 për Themelimin e Komisionit për Pranim, për të gjitha grupet për të cilat zhvillohet konkurrimi sipas shpalljeve publike për rekrutim.

Njësia për Burime Njerëzore më datë 16.06.2023 ka bërë Njoftimin për rezultatet e vlerësimit për pozitën „Zyrtar Ligjor 2” në Sektorin e Kadastrit në Komunën e Gjilanit. Ankuesi i pa kënaqur me vlerësimin e jetëshkrimit më datë 16.06.2023 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Pranim. Komisioni për Pranim më datë 21.06.2023 ka nxjerrë vendim me numër të protokollit Nr.02-60292 me të cilin e ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar duke e lënë ne fuqi njoftimin për rezultatet e vlerësimit të datës 16.06.2023.

Ankuesi, përmes e-mailit zyrtar [ankesa.kpmschck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmschck@rks-gov.net), më datë 23.06.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar nën shenjën A.nr.878/2023 dhe është protokolluar me numër 4888/2023, kundër Vendimit me numër 02-60292 të datës 21.06.2023, me pretendimin ankimor se lidhur me vlerësimin e jetëshkrimit komisioni nuk ka vlerësuar drejtë cilësinë dhe nivelin e arsimimit, nuk ka vlerësuar drejtë përvojën e punës dhe rezultatit e pikëve në këtë vlerësim.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, komform dispozitive Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 30.06.2023 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Komunën e Gjilanit. Ndërsa, Këshilli më datë 07.07.2022 ka pranuar përgjigje në ankesë provat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokollit 4888/2023 të datës 23.06.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër Nr.02-60292 të datës 21.06.2023; Diplomë me numër Nr.49/2013 e datës 18.10.2013; Diplomë e datës 30.03.2018; Vendimin me numër të referencës Ref.nr.6/900 i datës 18.07.2019; Certifikatë e datës 11.12.2015; Vërtetim i datës 23.11.2022; Pasqyra e trustit pensional për periudhën kohore 01.08.2002 deri 14.06.2023; Regjistrimi i Bujqësisë i datës 02.11.2014; Pasaportë e datës 01.09.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 30.06.2023; Përgjigje në ankesë e datës 07.07.2023; Konkursin me numër të referencës Nr. RN00011142 i datës 05.04.2023; Vendimin për Themelimin e Komisionit për Pranim me numër Nr.476 i datës 12.04.2023; Akt Emërimit me numër 02-016-102969 e datës 05.10.2017 i F.H; Akt Emërimit me numër AE. Nr. 02-016/01-0141928/22 e datës 14.12.2022 i V.B; Akt Emërimit 02-16-3076 i datës 09.01.2013 i S.F; Akt Emërimit me numër 02-16-19804 i datës 03.05.2011 i S.A; Vendimin me numër Nr.1248 të datës 23.11.2022; Listën e aplikantëve me numër reference RN00011142; Rezultatet përfundimtare; E-mail i datës 11.05.2023; E-mail i datës 12.06.2023; Formularin e intervistës me gojë i datës 14.06.2023; Renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 14.06.2023; Njoftim për Përmbledhjen e Vlerësimit me numër Nr.60540/23 i datës 22.06.2023; Ankesën e datës 16.06.2023 të parashtruar në Komisionin e pranimit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, konstaton se pretendimet e ankuesit ndaj konkursit me Nr. Reference RN00011143 për grupin Specialistë Ligjor për pozitën „Zyrtar Ligjor 2” në kuadër të Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë/Spektori i Kadastrit në Komunën e Gjilanit, janë të **pabazuara, sepse:**

Nga provat e lëndës, respektivisht në bazë të konkursit me Nr. Reference RN00011142 për grupin Specialistë Ligjor për pozitën „Zyrtar Ligjor 2” në kuadër të Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë/Sektori i Kadastrit si kërkesa të përgjithshme për pranim janë paraparë:

- *Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve; Diplomë e nivelit të pestë të KKK, për profesione Deficitar TIK;*
- *Kualifikime të posaçme formale: Fakulteti Juridik;*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 1 (një) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitë së listë të punës.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave ka konstatuar se për këtë pozitë kanë aplikuar katër dhjete e dy (42) kandidatë, ndërsa në listën e ngushtë janë përzgjedhur tridhjetë e pesë (35) kandidatë në mesin e tyre edhe ankuesi i cili e ka kaluar fazën e verifikimit, ndërsa më datë 11.05.2023 është ftuar të marrë pjesë në testin me shkrim, ku në bazë të rezulttit të testit me shkrim i njëjti ka marrë gjashtëdhjetë e pesë (65), pikë, ndërsa pas kësaj faze në fazën e vlerësimit të jetëshkrimit ankuesi është vlerësuar me tetë pikë pesë (8.5) pikë dhe i njëjti ka fituar të drejtën që ti nënshtrohet intervistës me gojë ku i njëjti pas mbajtjes së intervistës me gojë të datës 14.06.2023 ankuesi është vlerësuar nga Komisioni i pranimit në pajtim me nenin 16 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku është e përcaktuar se: “1.Vlerësimi i kandidatëve kryhet nga Komisioni i Pranimit. i themeluar në pajtim me nenin 17 dhe/ose përkatësisht neni 18 të kësaj Rregulloreje. 2.Vlerësimi i kandidatëve, përfshin, sipas radhës: 2.1. vlerësimin nëpërmjet një testimi me shkrim; 2.2. vlerësimin e jetëshkrimit /CV, dhe 2.3. vlerësimin nëpërmjet një interviste me gojë”, dhe pretendimet e ankuesit janë të pa bazuara pasi që në rastin konkret ankuesi me datë 16.06.2023 është njoftuar lidhur me pikët e përgjithshme ku në bazë të Formularit gjegjësisht renditjes përfundimtare të kandidatëve ankuesi është radhitur i katërti duke arritur gjithsejtë nga testi me shkrim, jetëshkrimi dhe intervista me gojë tetëdhjetë e një (81) pikë tw përgjithshme.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se gjatë këtij procesi ka pasur shkelje procedurale sepse vlerësimi i jetëshkrimit nga ana e Komisionit nuk i është bere ne mënyre te drejte, Kolegji ne baze te dëshmimeve te ofruara konkretisht në bazë tw formularit për CV ka gjetur se në këtë fazë në total ankuesi është vlerësuar me gjithsej tetë pikë pesë (8.5) pikë tw përgjithshme gjegjësisht ankuesi është vlerësuar me tetë (8) pikë për arsim ndërsa për cilësi është vlerësuar me pesë (5) pikë që në mbledhje dhe përpjesëtim me dy (2) vlerësimi ka rezultuar me gjashtë pikë pesë (6.5) pike për këtë pjesë, ngase në këtë pjesë kandidati vlerësohet veç e veç për nivelin e arsimit dhe cilësinë e arsimit, ndërsa sa i përket përvojës së punës është vlerësuar me dy (2) pike dhe për trajnime është vlerësuar me zero (0), andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave ne baze te dëshmimeve te ofruara ka konstatuar se Komisioni i Pranimit ka bërë vlerësimin e jetëshkrimit të ankuesit në pajtim me nenin 22 paragrafin 1, 2 dhe 4 nën paragrafi 4.1, 4.2, dhe 4.3 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, në të cilin është përcaktuar se: “1.Pas testimit me shkrim, vlerësimi i kandidatëve vazhdon me vlerësimin e jetëshkrimit. 2.Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën dyzet (40) pikë në testimin me shkrim, i nënshtrohen vlerësimit të jetëshkrimit. 4.Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin është deri ne njëzet (20) pikë, të ndara, si vijon: 4.1. deri ne tetë (8) pikë për cilësinë dhe nivelin të arsimit; 4.2. deri ne shtatë (7) pikë për përvojën domethënëse në punë; dhe 4.3. deri ne pesë (5) pikë për trajnimet”, sepse ne rastin konkret në bazë të dokumentacioneve te ofruara gjegjësisht Kolegji pasi ka analizuar dosjen e ankuesit të dorëzuar me rastin e aplikimit, ka konstatuar se i njëjti nuk ka bashkangjitur asnjë

certifikatë me të cilin dëshmohet pjesëmarrja dhe përfundimi i suksesshëm i ndonjë trajnimit, ndërsa për sa i përket përvojës së punës i njëjti bazuar në dëshmitë të cilat i ka paraqitur me rastin e aplikimit nuk ka arritur të dëshmojë përvojën e punës prej 1(një) viti përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës”, ashtu siç është kërkuar me konkurs përveç dëshmisë-Certifikatës së datës 11.12.2015 të lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës me të cilën dëshmohet se ankuesi ka punuar në Gjykatën Themelore të Gjilanit nga data 24.11.2014 deri më 23.11.2015, andaj në këtë rast pretendimi i ankuesit është i pabazuar.

Kolegji, po ashtu ka konstatuar se Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit me datë 16.06.2023 ka publikuar Njoftimin për Rezultete e Vlerësimit bazuar në renditjen përfundimtare sipas sistemi elektronik lidhur me përfundimin e procedurës së rekrutimit për grupin Specialistë Ligjor për pozitën „Zyrtar Ligjor 2” në kuadër të Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë/Spektori i Kadastrit, duke bërë renditjen përfundimtare sipas listës së rezultateve përfundimtare të gjashtw kandidatëve me mbi 70 pikët e arritura, ndërsa në baze të Njoftimit për përmbledhjen e vlerësimit të datw 22.06.2023 të publikuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit si kandidat i suksesshëm është përzgjedhur Aysel Abdulla që ka arritur gjithsejtë 87.5 pikët e përgjithshme, andaj Kolegji konstaton se publikimi është bërë në pajtim me nenin 9 dhe paragrafin 2 të nenit 25 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku është theksuar se: “2.Kandidatët që janë vlerësuar me shtatëdhjetë (70) pikë e më shumë, janë kandidatë fitues”, dhe ankuesi është renditur i katerti me gjithsejtë tetëdhjetë e një (81) pikët e përgjithshme, që në rastin konkret ankuesi në bazë të kësaj dispozite ka arritur mbi 70 pikë, por në raport me kandidatin e suksesshëm nuk ka arritur më shumë që të jetë i përzgjedhur si kandidat i parë, apo si kandidati i përzgjedhur.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për praninë në Komunë të Gjilanit, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokollit Nr.02-60292 të datës 21.06.2023 për ankesën e ankuesit të datës 16.06.2023, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, sepse është vërtetuar drejtë gjendja faktike dhe juridike, me të cilin e ka refuzuar ankesën e ankuesit duke konstatuar se vlerësimi i CV-sw, respektivisht jetëshkrimi është bërë konform ligjit dhe akteve nënligjore.

Andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se procedura e pranimit për grupin Specialistë Ligjor për pozitën „Zyrtar Ligjor 2” në kuadër të Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë/Spektori i Kadastrit me numër referencë RN000011142 është zhvilluar në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 6 dhe nenit 34 paragrafi 1, 2, 6, 7, 8, 9 dhe 10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 4, 7, 9, 14, 15, 16, 21, 22, 23 dhe 25, të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, kështu që pretendimet e ankuesit ndaj kësaj procedure janë të pabazuara.

Duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

*Lënda me numër A.nr.878/2022*

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

*[Signature]*  
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

*[Signature]*  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit, [redacted]
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

